Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***05.05.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***13.05.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***116/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.04.2022, OE ankues **"Haxhi Jaha",** ka parashtruar ankesë me nr: 116/22, kundër propozimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit**: "Furnizim me bateri",** me nr.të prokurimit**: TU-22-2515-1-3-6,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)**- Trafiku Urban.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë – Furnizim, vlera e vogël, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, , vlera e parashikuar e kontratës: 9 994, 00 €.

Data e njoftimit për kontratë 30.03.2022, Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 05.04.2022, kërkesa për rishqyrtim 22.04.2022, Vendimi nga ana e AK-se per kërkesën për rishqyrtim 26.04.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1: Qellimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - Pika 1

Neni 7: Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminim - Pika 2

Neni 28: Specifikimet teknike - Pika 3, Pika 4, Pika 6, Pika 9

Neni 60: Kriteret per dhenie te kontrates - Pika 1.1

Te Nderuar,

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-042 per Prokurim Publik ne Republiken e Kosoves I ndryshuar dhe plotesuar me Ligji Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, konsiderojm qe ne njoftimin per vendimin e AK jane shkelur dispozitat ligjore te ketij ligji-

Neni 1: Qellimi
Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - Pika 1
Neni 60: Kriteret per dhenie te kontrates - Pika 1.1

Qellimi i ketij ligji eshte shfrytezimi i fondeve publike dhe burimet publike ne menyre me ekonomike dhe me transparente ku ne si operator ekonomik gjate procedures se tenderimit jemi me qmim ekonomikisht me te lire si dhe te pergjegjshem.

Neni 7: Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminim - Pika 2
Neni 28: Specifikimet teknike - Pika 3, Pika 4, Pika 6, Pika 9

Ne konsiderojm qe AK ka bere shkeljen ligjore te ketyre neni gjate vleresimit te ofertes tone si operator ekonomikisht me i favorshme dhe i pergjejgjshem ngase ne specifikat teknike te vendosura nga AK ne Dosje te tenderit perkatesisht ne Aneksi 1 e qe ka te beje me specifikat teknike te detyrueshme ka kerkuar qe ndezja ne gjendje te ftohte (CCA), EN (A): te jete prej 1100 deri 1175, ne te njejten Dosje te tenderit eshte saktesuar qe bateria duhet te jete me standarde europiane ne si Operator ekonomik ekonomikisht me te favorshme kemi ofertuar (CCA), EN (A): 1300, me te gjitha standarde aplikueshme ne BE, ndersa AK na elimonon nga kjo procedure tenderuese me arsyetim qe ne kemi ofertuar diqka qe eshte me standard me te lart sesa kerkesa e AK.

Nese shikojm qka dmth CCA ateher ajo eshte numri I amperave qe bateria mundet te mbeshtes per 30seconda ne temp. 0 grade celsius. Kerkesa e AK eshte qe duhet te jete 1100- 1175ampera ndersa ne si operator ekonomik kemi ofertuar 1300ampera qe eshte me e larte dhe me favorshme sesa kerkesa e AK.

Ne pergjigjen e dhene nga AK ne kerkesen per rishqyrtim nga ana jone thuhet qe, citoje: “Sa per shqarime shtese ju informojme se specifikat (CCA), EN (A): 1300 ne autobuset e TU nga praktika e deri tashme ka dhene rezultatet jo te mira dhe jo ekuivalente me rekomandimet e prodhuesit IVECO BUS. Ky pretendim I AK nuk qendron pasi qe bateria e ofruar nga ne eshte me kualitet me te larte, poashtu ne shpjegime shtese nga prodhuesi (shih te bashkangjitur) tregohet qart qe bateria me kete fuqi ka mundesi me te mire te ndezjes dhe posaqerisht ne temperature te uleta dhe qe jan shume te rekomandueshme ne vendet e ftohta si dhe ne sezonat e dimerit ku temperaturat jane te uleta jane me efiqente per shkak te furnizimit me te madh te fuqize ndezese.

Konkludim:

Duke marr parasysh qe ne si operator ekonomik kemi ofertuar ekonomikisht me te favorshem si dhe duke pare qe gjate ofertimit tone ne kemi ofertuar bateria me standard te larta te BE si dhe me (CCA), EN (A) me te larte (e qe eshte me e favorshme) sesa kerkesa e AK, ne kerkojm qe njoftimi mbi vendimin e AK te anulohet lendate rikthehet ne rishyrtim si dhe te shperblehemi me kontrate.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Specifikat teknike	
Tensioni (V):	**12**
Kapaciteti I baterisë në AH	**225**
Gjatësia (mm):	**516 deri 518**
Gjerësia (mm):	**273 deri 276**
Lartësia (kg):	**240 deri 242**
Pesha (kg):	**55,50 deri 56,75**
Ndezja në gjendje të ftohtë (CCA), EN (A):	**1100 deri 1175**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PËR RISHQYRTIM)

VENDIM

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të aktiviteti të prokurimit : “Fumizim me Bateri ” me nr. të prokurimit: TU-22-2515-1-3-6 dhe nr. të brendshëm: TU-22-009- 136,
2. Vertetohet njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues i publikuar me datën 20.04.2022.

ARSYETIM

N.P.K Trafiku Urban SH.A përkatësisht komisioni vlerësues i caktuar nga KE ka bërë vlerësimin e ofertave në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe udhëzimin operativ për prokurim publik ,përkatësisht Nenet 1,6,7,28,60 te LPP-se gjatë vlerësimit të ofertave.

Komisioni nen mbikëqyrjen time si zyrtar përgjegjës ne zyrën e prokurimit ka vendosur për eliminimin e te gjithë operatoreve ekonomik dhe përkatësisht edhe te juve si OE me arsyetimin se nuk keni plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me saktesisht nuk keni plotesuar kerkesat e specifikacionit teknik. Ne specifika teknike eshte kerkuar qe (Ndezja në gjendje të ftohtë (CCA),EN(A): 1100 deri 1175). Ndërsa ju keni oferuar produktin me specifika (Ndezja në gjendje të ftohtë (CCA),EN (A) 1300). Sa për sqarime shtese ju informojmë se specifika (CCA),EN (A) 1300 ne autobusët e TU nga praktika e deri tashme ka dhënë rezultate jo të mira dhe jo ekuivalente me rekomandimet e prodhuesit IVECO BUS.

Për pretendimin ankimor lidhur me kursimin e buxhetit jemi te vetëdijshëm se neni 1 dhe 6 i LPP-se obligon AK qe te shfrytëzojë fondet ne mënyrë sa me efikase dhe ekonomike mirëpo duke u thirrur ne nenin 60 te LPP-se fillimisht tenderët duhet te vlerësohen nga ana administrative se a janë te përgjegjshëm dhe ne pajtim me kërkesat e dosjes se tenderit.

Qëndrimi i Autoritet kontraktues

Pretendimi ankimor nga Operatori Ekonomik N.P.T. ”Haxhijaha" Sh.p.k. nuk qëndron.

Bazuar ne sqarimet paraprake zyrtari përgjegjës i prokurimit konsideron se komisioni i vlerësimit nuk ka bere ndonjë shkelje ligjore dhe sipas kësaj ke vendosur si ne dizpozitiv. Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund te paraqes ankese pranë OSHP-se. Ankesa pranë oshp-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) dite pas pranimit të këtij vendimi.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.116/22 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti ka ofruar bateri e cila nuk është në përputhje me specfikacionin teknik ne ne dosje të tenderit.

Sipas AK-së është kërkuar abteri me CCA prej 1100 deri 1175, ndërsa OE ka ofruar bateri me CCA prej 1300.

Me gjithë se OE ankues pretendon se bateria me 1300CCA plotëson dhe tejkalon kërkesën e AK-së, AK anë arsyetim për refuzim të kërkesës për rishyqyrtim ndër tjera konstaton se :

“*Sa për sqarime shtese ju informojmë se specifika (CCA),EN (A)* ***1300*** *ne autobusët e TU nga praktika e deri tashme* ***ka dhënë rezultate jo të mira*** *dhe* ***jo ekuivalente me rekomandimet e prodhuesit IVECO BUS****.”.*

Pas analizimit të dosjes dhe pretendimeve ankimore, gjatë hulumtimeve të bëra kemi gjetur se numër më I lartë I CCA-ve nuk nënkupton domosdoshmërisht bateri më kualitative.

Nga huluimti tona online kemi gjetur se shpeshëherë për të rritur numrin e CCA në bateri shtohen më shumë pllaka, e keqja e kësaj megjithatë është se trashësia dhe madhësia e pllakës dhe materiali ndarës zakonisht sakrifikohet. Në klimat e ftohta, më shumë pllaka në bateri ofrojnë CCA më të larta, por në klimat më të ngrohta efekte

anësore te pllakave të holla janë korrozioni, humbja e ujit, dridhjet dhe boshetimi i vazhdueshëm mund ta sjellin jetëgjatësi më të shkurtë të baterisë.

Ne nuk mund të pohojmë se kjo është situata që kemi në rastin konkret me produktet e OE ankues, me gjithë këtë kjo mund të jetë arsye që AK ka caktuar saktësisht minimumin prej 1100 dhe maksimumin prej 1175, ku AK po ashtu thirret në rekomandimet e vet prodhuesit të autobusëve në të cilët do të montohen dhe shfrytëzohen këto bateri.

OE ankues ka ofruar bateri me CCA më lartë se maksimumi i vendosur/lejuar nga AK, në të njëjtën kohë nuk mund të dëshmojmë se opsioni i ofruar nga OE ankues është ekuivalent ose më i mirë se ajo qka është kërkuar nga AK në dosje të tenderit, për arsyet e cekura si më lart.

Bazuar në gjitah këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është pabazuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, në të njëjtën kohë prpozpojmë që të vërtetohet vendimi i AK-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Trafiku Urban.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - “Haxhi Jaha”